



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
GRUPI I PUNËS AD - HOC

**REKOMANDIME MBI
“RAPORTIN E ANALIZËS SË
REZULTATEVE TË
PYETËSORIT TË STUDENTËVE
PËR VLERËSIMIN DHE
PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË
SHËRBIMEVE TË OFRUARA
PREJ STAFIT NDIHMËS
AKADEMIK DHE
ADMINISTRATIV”!
VITI AKADEMIK 2023-2024**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
GRUPI I PUNËS AD HOC

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në përmbushje të Standardit V.5 të Kodit të Cilësisë “*Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) përfshin dhe angazhon studentë në organet vendimarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre*”, në Statutin e Universitetit të Vlorës, Neni 73, Pika d: “*Studentët kanë të drejtë të shprehin vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit në Universitet*”, si dhe të aktiviteteve të parashikuara në Planin e Masave për Përmbushjen e Rekomandimeve të lëna prej Bordit të Akreditimit për akreditimin e programeve të studimit si dhe akreditimin periodik institucional. Gjatë vitit akademik 2023-2024 është implementuar për vitin e katërt radhazi instrumenti i Pyetësorit të Studentëve për Vlerësimin dhe Përmirësimin e Cilësisë së Shërbimeve të ofruara prej stafit administrativ dhe ndihmësakademik, miratuar me VSA Nr. 51 datë 20.09.2019¹, i ndryshuar me VSA Nr. 25, datë 12.05.2021². Ndër qëllimet kryesore të UV-së në përdorimin e këtij instrumenti përmendim:

1. *Cilësia e shërbimeve*: Mangësi dhe vërejtje në lidhje me cilësinë e shërbimeve mbështetëse, duke përfshirë vonesa në përgjigje dhe mungesë efikasiteti në zgjidhjen e çështjeve të studentëve.
2. *Komunikimi*: Mungesa e një komunikimi të qartë dhe të efektshëm midis administratës dhe studentëve ka sjellë konfuzion dhe pakënaqësi.
3. *Pjesëmarrja në anketim*: Edhe pse ka një rritje të pjesëmarrësve në pyetësor, ende ka sfida për të angazhuar më shumë studentë në këtë proces.

¹ <https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/10/vendim-nr-51.pdf>

² <https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2021/05/Vendim-Senati-Nr.-25-date-12.05.2021-Per-nje-ndryshim-ne-VSA-nr.51date-20.09.2019-.....pdf>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
GRUPI I PUNËS AD HOC

4. Nevojat e studentëve: Nuk janë identifikuar dhe përmyllur plotësisht nevojat specifike të studentëve, duke çuar në një perceptim të përgjithshëm të pamjaftueshmërisë së shërbimeve.
5. Evente dhe aktivitetet promovionale: Organizimi i aktiviteteve, workshop-eve dhe ngjarjeve promovionale për të ndihmuar në informimin e studentëve mbi mundësitë e aktiviteteve dhe jetën universitare.
6. Feedback nga studentët: Përdorimi i feedback-ut të studentëve për të përmirësuar strategjitë e marketingut dhe për të ofruar informacione që janë me të vërtetë të dobishme për ata që po shqyrtojnë regjistrimin.
7. Përdorimi i teknologjisë: Rritja e përdorimit të platformave digjitale dhe mediave sociale për të arritur një audiencë më të gjerë. Kjo mund të ndihmojë në angazhimin e studentëve dhe në rritjen e njohjes së universitetit.

Ky pyetësor ka për qëllim të mbledhë informacion të vlefshëm për të kuptuar më mirë nevojat dhe preferencat e studentëve të Universitetit të Vlorës, me qëllim përmirësimin e shërbimeve mbështetëse që ofrohen. Përmes këtij procesi, universiteti mund të krijojë një pasqyrë të qartë mbi përvojën e studentëve dhe të identifikojë mundësi për rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve. Në këtë mënyrë, synohet që shërbimet e universitetit të jenë më të përshtatshme dhe të kënaqshme për studentët.

Grafiku më poshtë ilustron ndryshimet në numrin e pjesëmarrësve në pyetësor gjatë viteve akademike 2021-2022, 2022-2023 dhe 2023-2024. Megjithëse numri i pjesëmarrësve për vitin akademik 2023-2024 është më i lartë se në vitin 2022-2023, rritja e mëtejshme e këtij numri mbetet një sfidë e hapur. Objektivi kryesor është të gjenden mënyra për të rritur angazhimin e studentëve në këtë proces anketimi. Duke vërejtur grafikun e mëposhtëm shohim një rënie të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
GRUPI I PUNËS AD HOC

pjesëmarrësve me rreth 16.3% nga viti akademik 2021-2022 në 2022-2023 të studentëve në pyetësor, si dhe një përqindje prej 59.7% në rritje nga 2022-2023 në 2023-2024.




Figure 1

Gjatë analizës së të dhënave të pyetësorit prej NJSBCVI-së janë evidentuar disa problematika në nivel institucioni ku veçojmë:

1. Pjesëmarrje e ulët të studentëve: Në pyetësor kanë marrë pjesë vetëm 11.65% e studentëve frekuentues gjatë vitit akademik 2023-2024, një shifër kjo pak më e lartë se viti I mëparshëm, por e ulët për implementimit të këtij instrumenti. Pjesëmarrja e ulët e studentëve në plotësimin e pyetësorit mund të ketë disa ndikime, ku theksojmë:

- *Mungesa e informacionit:* Studentët mund të mos jenë të informuar mjaftueshëm mbi rëndësinë e pyetësorit dhe ndikimin e tij në përmirësimin e shërbimeve. Duke i bërë ata më pak të motivuar për të marrë pjesë.
- *Sigurimi i anonimitit:* Disa studentë mund të kenë frikë se përgjigjet e tyre nuk do të mbeten anonime, duke i bërë ata të ngurrojnë të shprehin mendimet e tyre të sinqerta.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
GRUPI I PUNËS AD HOC

- *Mungesa e dëshirës së pjesëmarrjes:* Një përqindje e ulët e pjesëmarrjes mund të reflektojë një ndjenjë të ulët angazhimi nga ana e studentëve, duke çuar në rënie besimin, se opinioni i tyre nuk ka rëndësi në procesin vendimmarrës.
- *Mungesa e angazhimit:* Studentët nuk përkushtohen plotësisht për të kuptuar pyetjet, duke u përgjigjur sipas impulsit ose pa i analizuar ato, me përgjegjësi.

Këto ndikime theksojnë nevojën për të zhvilluar strategji të reja që do të rrisin angazhimin e studentëve dhe do të sigurojnë që zëri i tyre të merret parasysh në mënyrë efektive. Për t'u përballur me këto sfida, është e rëndësishme të aplikohen taktika që nxisin pjesëmarrjen e studentëve në plotësimin e pyetësorit. Kjo mund të realizohet përmes fushatave informative më të strukturuar, duke u siguruar që pyetësi të jetë i lehtë për t'u aksesuar dhe plotësuar, të garantohet anonimiteti dhe të ofrohen mundësi që studentët të ndihen të përfshirë dhe të vlerësuar. Rritja e pjesëmarrjes do të mundësojë mbledhjen e një feedback-u më të besueshëm dhe të saktë, që është thelbësor për përmirësimin e shërbimeve mbështetëse të universitetit. Gjithashtu, një angazhim më i lartë i studentëve do të kontribuonte në përmirësimin e cilësisë së përfshirjes së tyre, si në aspektin akademik edhe social, duke ndihmuar në konsolidimin e imazhit dhe statusit të Universitetit të Vlorës, si në rajon ashtu edhe në nivel më të gjerë.

2. Mungesa e të dhënave në nivel njësie kryesore/njësie bazë: Mungesa e të dhënave për njësinë kryesore ose njësinë bazë, ku studentët ndjekin studimet në rezultatet e pyetësorit, mund të ketë ndikime të rëndësishme si:

- *Vështirësi në identifikimin e problemeve specifike:* Ky është një problem i vazhdueshëm përgjatë 4 (katër) viteve të implementimit të pyetësorit. Pa të dhëna të detajuara për njësinë bazë, është e vështirë për të identifikuar problemet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
GRUPI I PUNËS AD HOC

specifike apo sfidat që studentët mund të përjetojnë në atë fushë studimi. Kjo mund të bëjë që rekomandimet për përmirësimin e shërbimeve të jenë të përgjithshme dhe jo plotësisht të përshtatshme për nevojat e secilës njësi, duke e bërë analizën të përgjithshme dhe më pak efektive.

- *Mospërputhja e rezultateve:* Pa të dhëna të njësisë bazë, rezultatet e pyetësorit mund të mos reflektojnë realitetin specifik të studentëve të atij programi apo njësie. Kjo mund të çojë në gabime dhe pasaktësira në vlerësimin dhe plotësimin e nevojave reale të studentëve.

Për të rritur efikasitetin e pyetësorit, është e nevojshme të krijohen strategji të forta për angazhimin e studentëve dhe mbledhjen e të dhënave të detajuara për njësitë. Kjo kërkon përpjekje si nga studentët, por dhe nga stafi akademik dhe administratës. Duhet të jetë një proces i vijueshëm për të garantuar përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve dhe cilësisë akademike në universitet.

Është e domosdoshme të sigurohet mbledhja e të dhënave të plota dhe të detajuara në nivelin e njësisë të studimit, për të mundësuar një vlerësim më të saktë dhe përmirësime më efektive. Për ta realizuar këtë, është e rëndësishme që pyetësori për vlerësimin e shërbimeve të përfshijë pyetje të detajuara që lidhen drejtpërdrejt me njësinë bazë të studimit.

Për të identifikuar saktësisht njësinë kryesore të cilës i përkasin studentët, mund të sugjerohet që plotësimi i pyetësorit të bëhet nëpërmjet llogarisë personale të studentëve në platformën UVMS. Në rast se krijimi i një platforme të veçantë për pyetësorin nuk është i mundur, mund të rekomandohet shtimi i një pyetjeje të veçantë në seksionin e katërt (të dhëna demografike) që do të identifikojë njësinë kryesore të studentëve.

Kjo pyetje do të ndihmojë në mbledhjen e të dhënave të detajuara dhe të specifikuara për secilën njësinë, e cila është thelbësore për përmirësimin e përvojës akademike të studentëve, mundësinë e një analize më të thelluar dhe më të fokusuar të nevojave specifike të studentëve, duke kontribuar në optimizimin e shërbimeve dhe mbështetjes që ofrohen.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
GRUPI I PUNËS AD HOC

Sekretaritë mësimore

Kufizimi i mungesës së informacionit në lidhje me njësinë kryesore/bazë, e ka bërë të vështirë identifikimin e sekretarive që janë vlerësuar më mirë në krahasim me të tjerat, duke e bërë të ndërlikuar përcaktimin e sektorëve ku studentët ndiejnë se ka nevojë për përmirësim. Megjithatë, një analizë e përgjithshme e rezultateve të pyetësorit për vitin akademik 2023-2024 tregon se 56.9% e studentëve e vlerësojnë sekretarinë mësimore si gjithmonë të ofrueshme në kohë, me përgjigje të qarta dhe të drejtpërdrejta, duke respektuar etikën në komunikim, një rritje prej 1.7% krahasuar me vitin e kaluar.

Kur krahasojmë këtë vit me vitin e kaluar, vërehet një rritje në numrin e studentëve që frekuentojnë sekretaritë dhe në shpeshësinë e marrjes së përgjigjeve, 7.3% më shumë studentë kanë deklaruar se frekuentojnë gjithmonë sekretaritë dhe marrin përgjigje të qarta. Ndërkohë, ka një ulje prej 0.9% në vlerësimin pozitiv të etikës në komunikim.

Pavarësisht kësaj rritjeje, studentët në pyetjet e hapura kanë shprehur se nuk do të dëshironin të ndryshonin asgjë në këtë sektor, duke vlerësuar mirëkuptimin dhe qartësinë e informacionit të ofruar. Megjithatë, disa studentë sugjerojnë përmirësime në disa aspekte, përfshirë saktësinë e informacionit, etikën, sjelljen e stafit, vonesat në marrjen e përgjigjeve, dhe mosmarrjen e përgjigjeve në disa raste. Këto sugjerime tregojnë se, ndonëse vlerësimet janë pozitive, ka ende mundësi për përparim në ofrimin e shërbimeve nga ana e sekretarive. **Duke u bazuar në komentet e studentëve tek pyetjet e hapura, rekomandohet:**

- *Përmirësim në komunikim:* Trajnime për stafin mbi etikën dhe teknikën e komunikimit, për të siguruar që studentët të ndihen të respektuar dhe të kuptuar. Zhvillimi i një kanali komunikimi të qartë dhe të lehtë, si e-maili ose një platformë online, për të lehtësuar pyetjet dhe përgjigjet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
GRUPI I PUNËS AD HOC

- *Rritja e gatishmërisë së stafit:* Inkurajimi i stafit për të qenë më të gatshëm të ndihmojnë studentët dhe për të ofruar asistencë të shpejtë. Vendosja e një politike që nxit përgjegje të shpejta për kërkesat e studentëve.
- *Bashkëpunimi midis departamenteve dhe sekretarive mësimore:* Krijimi i një platforme për ndarjen e informacionit mes departamenteve dhe sekretarive, për të përmirësuar koordinimin dhe komunikimin. Organizimi i takimeve periodike midis departamenteve dhe sekretarive për të diskutuar problemet e hasura dhe zgjidhjet e mundshme.
- *Trajnim i stafit dhe zhvillim profesional:* Duke investuar në këto programe trajnimi, universiteti do të mundësojë një shërbim më të kualifikuar dhe më të efektshëm, duke rritur kështu kënaqësinë dhe pritshmërinë e studentëve si dhe duke përmirësuar përvojën e tyre akademike.

Zyra e Shërbimit ndaj Studentit

Përmes analizës së rezultateve të pyetësorit për vitin akademik 2023-2024, vihet re se 40% e studentëve e kanë frekuentuar *rrallë* ose *asnjëherë* zyrën e studentit, çka tregon një ulje prej 13.9% krahasuar me vitin e kaluar. Megjithatë, studentët që kanë vizituar zyrën e studentit kanë shprehur kënaqësi për përgjigjet e qarta dhe të drejtpërdrejta që kanë marrë nga stafi, të cilët kanë respektuar etikën e komunikimit.

Kjo kënaqësi pasqyrohet edhe në pyetjet e hapura, ku rreth 45.7% e studentëve që dhanë komentet e tyre, shprehën se nuk do të dëshironin asnjë ndryshim në shërbimet e ofruara, duke vlerësuar pozitivisht komunikimin dhe ndihmën që morën. Pjesa tjetër e studentëve, megjithatë, sugjeroi përmirësime në mënyrën e komunikimit, duke kërkuar një rritje të efikasitetit dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
GRUPI I PUNËS AD HOC

qartësisë në trajtimin e çështjeve të tyre. Kjo tregon se, ndërkohë që shumica e studentëve janë të kënaqur me shërbimin e ofruar, ka ende mundësi për përmirësime të mëtejshme në këtë fushë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

- *Sigurimi i pranisë së stafit:* Të planifikohet një sistem për të siguruar që personeli të jetë gjithmonë i pranishëm në zyrat e studentëve gjatë orarit të punës, duke minimizuar mungesat.
- *Përmirësimi i komunikimit:* Të krijohet një platformë për komunikim të vazhdueshëm, ku studentët mund të shprehin shqetësimet e tyre dhe të marrin përgjigje në kohë.
- *Trajnime për etikën në komunikim:* Të organizohen trajnime për stafin mbi etikën dhe mënyrën e duhur të komunikimit me studentët, për të ndihmuar në krijimin e një atmosfere miqësore dhe mbështetjeje.
- *Njoftime periodike:* Të vendoset një sistem për të informuar studentët përmes email-it ose platformave të tjera mbi ngjarjet e rëndësishme, mbi vendimet për bursat, tarifat, etj.

Spektori i Këshillimit të Karrierës, ALUMNI dhe Aktiviteteve kulturore-sportive. (Alumni-studentë të diplomuar në vite në UV)

Pjesëmarrja e ulët e studentëve në aktivitetet e organizuara nga ky sektor vazhdon të mbetet një shqetësim. Gjatë vitit akademik 2023-2024, 39.6% e studentëve nuk janë angazhuar në këto aktivitete, duke shënuar një rënie prej 5.6% krahasuar me vitin e kaluar. Megjithatë, ata që kanë marrë pjesë kanë vlerësuar pozitivisht etikën në komunikim të specialistëve dhe cilësinë e aktiviteteve.

Edhe pse ka një vlerësim pozitiv nga ata që kanë marrë pjesë, është e domosdoshme të organizohen aktivitete të tjera, më të përshtatshme për programet e studimit dhe interesat e studentëve. Këto aktivitete mund të kontribuojnë në rritjen e pjesëmarrjes dhe krijimin e një ambienti më dinamik dhe të angazhuar për studentët pjesëmarrës. Këto hapa do të ndihmojnë në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
GRUPI I PUNËS AD HOC

përmirësimin e angazhimit të studentëve dhe në pasurimin e përvojës së tyre arsimore jashtë mësimit. **Për sa më sipër rekomandohet:**

- *Rritja e larmisë së aktiviteteve:* Të ofrohen aktivitete që pasqyrojnë interesat dhe nevojat e ndryshme të studentëve, përfshirë seminare, workshop-e dhe evente të ndryshme.
- *Promovimi i aktiviteteve:* Duhet fushata intensive informuese për aktivitetet e planifikuara, duke përdorur kanale si rrjetet sociale, faqen e web-it, email-et.
- *Nxitje për pjesëmarrje:* T'u ofrohet studentëve pjesëmarrës në aktivitete, certifikata për të nxitur angazhimin e tyre.
- *Feedback nga studentët:* Të organizohen takime me studentët për të diskutuar dhe identifikuar aktivitete të reja që ata do të kishin interes për t'u përfshirë.
- *Krijimi i një sistemi mbështetës për studentët:* Mund të krijohet një sistem mbështetës që ndihmon studentët të identifikojnë mundësitë e karrierës, praktikat profesionale dhe mundësitë për zhvillim personal. Kjo do të rrisë mundësitë e punësimit për studentët dhe do të forcojë lidhjet me industrinë dhe bizneset që kërkojnë fuqi punëtore.

Spektori i Bibliotekës Shkencore

Në këtë sektor, shihet një interes mjaft i ulët i studentëve për të frekuentuar bibliotekën, përfshirë bibliotekën online. Rreth 47.3% e studentëve pjesëmarrës në pyetësor gjatë vitit akademik 2023-2024 kanë deklaruar se e kanë frekuentuar atë "rrallë" ose "asnjëherë". Sipas studentëve, ky interes i ulët lidhet kryesisht me mungesën e informacionit nga ana e Universitetit të Vlorës.

Për ata studentë që e kanë vizituar bibliotekën gjatë vitit 2023-2024, vlerësimet janë pozitive në lidhje me literaturën, e cila plotëson nevojat akademike të studentëve, si dhe me etikën në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
GRUPI I PUNËS AD HOC

komunikim të personelit të bibliotekës. Gjithashtu, orari i shërbimit është vlerësuar si i përshtatshëm për studentët.

Megjithatë, studentët kanë veçuar disa aspekte që kërkojnë përmirësim, kryesisht në lidhje me kapacitetin e pritjes, literaturën bashkëkohore dhe mjetet teknologjike në dispozicion. Këto sugjerime tregojnë se, përkundër vlerësimeve pozitive, ka ende mundësi për përmirësime në këto fusha që mund të nxisin një angazhim më të madh të studentëve në shfrytëzimin e bibliotekës dhe burimeve të saj. **Për sa më sipër rekomandojmë:**

- ♣ *Mungesa e librave dhe literaturës shkencore:* Shumë studentë kanë kërkuar shtimin e librave, veçanërisht në fushat shkencore. Shtimi i librave dhe materialeve përkatëse për lëndët universitare, sidomos për shkencat kompjuterike dhe degët që kërkojnë literaturë të avancuar.
- ♣ *Biblioteka online dhe përditësimi:* Disa studentë nuk janë të informuar për bibliotekën online të universitetit. Krijimi i një fushate informuese për të nxitur studentët që të përdorin bibliotekën online dhe të sigurohen që çdo student të di se si mund të qaset në këtë shërbim. Gjithashtu, përditësimi i katalogut të bibliotekës është një kërkesë tjetër e studentëve.
- ♣ *Mungesa e personelit në bibliotekë:* Një tjetër shqetësim i shfaqur është mungesa e personelit në bibliotekë. Ky problem është theksuar edhe nga studentët që kanë nevojë për asistencë dhe mbështetje për kërkimet e tyre. Mund të rritet numri i orëve të mbështetjes, përfshirë mbështetje online për pyetje që lidhen me përdorimin e burimeve të bibliotekës.
- ♣ *Zgjerimi i Kapaciteteve:* Rritja e kapacitetit të bibliotekës, si përmes zgjerimit të hapësirave fizike ashtu edhe duke ofruar mundësi më të mira për studime individuale dhe grupe.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
GRUPI I PUNËS AD HOC

Laboratorët /Qendrat Kërkimore Shkencore pranë Fakulteteve

Rezultatet e pyetësorit për vitin akademik 2023-2024 tregojnë se frekuentimi i Qendrave Kërkimore Shkencore (QKSH) në fakultete ka qenë i ulët, me rreth 37.6% të studentëve që nuk i kanë vizituar *asnjëherë* ose *rrallëherë*. Frekuentimi i këtyre qendrave është një mundësi e çmuar për studentët, pasi u ofron atyre mundësinë për të bashkëpunuar me profesorë dhe ekspertë në fushat e tyre, për të eksploruar tema të ndryshme, për të thelluar njohuritë mbi konceptet e mësuara në klasë dhe për të zhvilluar aftësitë kërkimore. Kjo përvojë mund të jetë thelbësore për rritjen e kapaciteteve akademike të studentëve dhe për zhvillimin e karrierës së tyre.

Për këtë arsye, është e rëndësishme që profesorët dhe stafi akademik të nxisin përdorimin e këtyre qendrave përmes projekteve kërkimore, detyrave akademike, si dhe organizimit të orëve të hapura pranë QKSH-ve. Disa studentë kanë sugjeruar mundësi më të shumta për të përdorur laboratorët dhe qendrat kërkimore, duke theksuar se një angazhim më i madh në këto aktivitete mund të përmirësojë aftësitë dhe njohuritë e tyre praktike.

Për ata studentë që kanë frekuentuar laboratorët dhe qendrat kërkimore, vlerësimet janë kryesisht pozitive, veçanërisht në lidhje me etikën në komunikim të stafit ndihmës akademik dhe infrastrukturën logjistike të këtyre ambienteve. Sidoqoftë, një pjesë e studentëve, rreth 16.5%, kanë shprehur shqetësime lidhur me nevojën për përmirësime të infrastrukturës logjistike të laboratorëve, duke kërkuar mundësi më të mira për angazhim në aktivitete praktike dhe kërkimore. Këto masa mund të kontribuojnë në rritjen e angazhimit të studentëve në kërkime shkencore dhe aktivitete praktike, duke përmirësuar kështu cilësinë e arsimit dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës. **Për sa më sipër sugjerohet:**

- ❖ *Nxitja e përdorimit të QKSH:* Profesorët mund të organizojnë projekte kërkimore dhe orë të hapura për të inkurajuar studentët të angazhohen më shumë me këto qendra dhe të përfitojnë nga mundësitë e ofruara për zhvillim profesional dhe kërkimor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
GRUPI I PUNËS AD HOC

- ❖ *Përmirësimi i infrastrukturës:* Investimi në përmirësimin e infrastrukturës logjistike të laboratorëve dhe qendrave kërkimore është i domosdoshëm për të siguruar një mjedis më të përshtatshëm dhe më funksional për studentët që angazhohen në aktivitete praktike.
- ❖ *Mundësi për aktivitetet praktike dhe kërkimore:* Rritja e mundësive për angazhim të drejtpërdrejtë të studentëve në aktivitete kërkimore dhe praktike do të ndihmojë në zhvillimin e aftësive të tyre dhe në përmirësimin e përvojës së tyre akademike.
- ❖ *Shtimi i pajisjeve dhe materialeve mësimore:* Shtimi i më shumë pajisjeve dhe materialeve përkatëse për lëndët laboratorike, përfshirë pajisje të specializuara për fushat e ndryshme si kimia, biologjia, dhe shkencat kompjuterike. Kjo do t'u mundësojë studentëve të përfshihen në eksperimente dhe aktivitete praktike më të plota dhe të përmirësojnë cilësinë e mësimin.

Sektori i IT-së

Përgjatë vitit akademik 2023-2024 studentët kanë vlerësuar me 84.7% pozitivisht shërbimet IT të ofruara në UV si të mirë dhe shumë të mirë. Megjithatë pavarësisht pyetjeve të mbyllura ku përgjithësisht rezultatet në pyetësorë tregojnë një performancë të mirë të sektorit IT, në pyetjen e hapur studentët janë shprehur se *shpeshherë* hasin vështirësi në aksesim, në azhornimin e sistemit UVMS, apo në përditësimin e informacioneve në faqen e web-it. Rekomandimet përfshijnë përmirësimin e sistemeve teknologjike, lehtësimin e proceseve, përmirësimin e aksesueshmërisë. Këto masa do të përmirësojnë efikasitetin e universitetit dhe do të rrisin kënaqësinë e studentëve me shërbimet që ofrohen. Implementimi i këtyre rekomandimeve do të kontribuonte në rritjen e efikasitetit të shërbimeve IT, duke përmirësuar kënaqësinë e studentëve dhe duke optimizuar përvojën e tyre akademike dhe administrative në universitet.

Për sa më sipër rekomandojmë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
GRUPI I PUNËS AD HOC

- *Përditësimi dhe struktura e faqes Web:* Studentët kërkojnë një informacion më të strukturuar dhe të aksesueshëm në lidhje me universitetin dhe njoftimet e tij. Përmirësimi i strukturës së faqes web duke kategorizuar më mirë informacionet dhe duke i përditësuar ato më shpesh. Një sistem më i mirë për ndarjen e informacionit mund të përfshijë seksione si "Lëndët dhe Kreditet", "Njoftime të Reja", etj. Kjo do t'i mundësonte studentëve të gjenin informacionin që u nevojitet më shpejt dhe më lehtë, duke ulur pasigurinë dhe konfuzionin.
- *Rritja e lehtësimit për oraret dhe informacionin mbi provimet:* Studentët kërkojnë që oraret e provimeve të jenë më të aksesueshme dhe të shfaqen në faqet e tyre individuale. Për më tepër, mund të implementohet një sistem njoftimesh që dërgon një e-mail kur ora e provimit ka ndryshuar ose është përcaktuar. Ky sistem do t'a bëjë më të lehtë për studentët të gjejnë informacionet e provimeve pa kërkuar, duke parandaluar çdo konfuzion dhe duke i mbajtur ata të informuar dhe përditësuar.

Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Duke u bazuar në rezultatet e përgjigjeve për këtë sektor vihet re se 36.4% e studentëve janë shprehur se nuk kanë marrë pjesë *asnjëherë* ose *rrallëherë* në aktivitetet e realizuar prej SPMJ, një shifër kjo e cila kërkon akoma edhe më tepër angazhim, pavarësisht se ka një përmirësim të rezultatit me 13.6% më e ulët se një vit më parë. Për pothuajse të gjithë studentët që kanë marrë pjesë në pyetësorë, personeli i SPMJ ka respektuar etikën në komunikim si dhe i kanë vlerësuar aktivitetet e organizuara prej tyre.

Sidoqoftë, një pjesë e konsiderueshme e studentëve kanë sugjeruar që aktivitetet janë ende të pamjaftueshme dhe se do të ishte e nevojshme më shumë mundësi informimi për të rritur pjesëmarrjen. **Për sa më sipër sugjerohet:**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
GRUPI I PUNËS AD HOC

- ✚ *Më shumë aktivitetete dhe shkëmbime ndërkulturore:* Prezantimi i shkëmbimeve kulturore dhe aktivitetet me studentët ndërkombëtarë, që mundësojnë shkëmbime kulturore mes studentëve të ardhur nga rajone të ndryshme të Shqipërisë dhe shteteve të tjera. Prezantimi i kulturave të ndryshme mund të ndihmojë në ndërtimin e një komuniteti studentor më të hapur dhe tolerant. Këto aktivitete mund të krijojnë mundësi për rritjen e ndërveprimit dhe të ndihmojnë studentët të krijojnë lidhje ndërkombëtare, shkëmbime gastronomie, duke pasuruar përvojën e tyre akademike, gjuhësore dhe kulturore.
- ✚ *Angazhimi i studentëve në proceset e planifikimit të aktiviteteteve:* Përfshirja e studentëve në planifikime të aktiviteteteve. Ata mund të ofrojnë ide dhe sugjerime për aktivitetet që mund të zhvillohen dhe mund të kontribuojnë në realizimin e tyre. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së aktiviteteteve, duke siguruar që ato të jenë në përputhje me kërkesat dhe preferencat e studentëve si dhe në rritjen drejtpërdrejtë të pjesëmarrjes.

Vlerësimi Infrastrukturës

Për aspektet, si mjediset e auditorëve, sistemin e ndriçimit, cilësinë e bazës materiale, si dhe higjenën e auditorëve, janë ndërmarrë disa masa nga UV si vihet re dhe nga përgjigjet pozitive të studentëve krahasuar me një vit më parë. Rreth 86.4% e studentëve janë shprehur se mjediset e auditorëve kanë kushte *shumë të mira* dhe *të mira* duke treguar një përmirësim të dukshëm në këto aspekte.

Gjithashtuv një pjesë e konsiderueshme e studentëve, rreth 32.1%, vazhdojnë të vlerësojnë negativisht sistemin e ngrohjes/ftohjes, si dhe higjenën e tualeteve, ku 26.6% e pjesëmarrësve e kanë cilësuar atë si të *keq* ose *shumë të keq*. **Për sa më sipër sugjerohet:**

- *Përmirësimi I sistemit të ngrohjes dhe ftohjes:* Parashikimi në buxhetin e UV-së për përmirësimin e kushteve të sistemit të ngrohje/ftohjes së auditorëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
GRUPI I PUNËS AD HOC

- *Përmirësimi I kushteve higjeno-sanitare:* Të përmirësohet higjena e tualeteve, duke plotësuar të gjitha standardet higjeno-sanitare. Instalimi i aparateve të sapunit dhe letrave higjenike në tualete dhe mundësia e pastrimit të rregullt të ambienteve.
- *Investim në infrastrukturën e universitetit:* Pavarësisht investimeve të realizuara, në zbatim të rekomandimeve të lëna, rregullimi i klasave dhe auditorëve me materiale dhe ndriçim të përshtatshëm, mund të jetë e dobishme, përmirësimi i ajrit dhe ventilimit.
- *Investim në teknologji dhe pajisje:* Blerja e projektorëve, whiteboard dhe pajisje të tjera që mundësojnë zhvillimin e leksioneve në mënyrë moderne dhe efikase.

GRUPI I PUNËS

- Prof. As Majlinda Zahaj (Zv. Rektor) – **Kryetar**
- Rezarta Sinanaliaj (Drejtore DSBCP) – **Anëtar**
- Romina Xhelaj (Përgjegjëse NJSBCVI) – **Anëtar**
- Harikla Beduli (Specialist NJSBCVI) – **Anëtar**
- Gjergji Iljadhi (Specialist) – **Anëtar**